



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish - hotel "Drini", Tiranë

Tel:04 22268141/ 2 2268142

Nr. 133/8 aktit

Tiranë 05.09.2017

**V E N D I M**

**Nr. 187, datë 05.09.2017**

***"Mbi përfundimin e procedimit administrativ,  
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 133/2 prot., datë 03.03.2017"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me ligjshmërinë e procedurës së transferimit të punonjësës \*\*\*\*\* , për shkak të ristrukturimit të këtij institucioni, kryer nga Komisioni i Ristrukturimit, në Këshillin e Qarkut Shkodër,

**VËREJ SE**

Me Urdhrin nr. 133/2 prot., datë 03.03.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u verifikua informacioni i përcjellë nëpërmjet kërkesës nr. 133 prot., datë 20.02.2017, paraqitur nga punonjësja \*\*\*\*\* , pranë Këshillit të Qarkut Shkodër, që lidhet me, ligjshmërinë e procedurës së transferimit të saj, për shkak të ristrukturimit të këtij institucioni, kryer nga Komisioni i Ristrukturimit.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 133/3, datë 03.03.2017, u vu në dijeni Këshilli i Qarkut Shkodër, për fillimin e këtij verifikimi, si dhe u kërkua nga institucioni, dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e tij.

Shqyrtimi i kësaj çështje, është bazuar tek informacioni ardhur me shkresën e protokolluar me nr. 133 prot., datë 20.02.2017, të punonjësës \*\*\*\*\* , nga shkresa nr. 246/1 prot., datë 07.03.2017 "Kthim Përgjigje dhe Dërgim Dokumentacioni", e Këshillit të Qarkut Shkodër, ardhur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe regjistruar, me nr. 133/6 prot.,

datë 09.03.2017, si dhe nga dokumentacioni i marrë në Këshillin e Qarkut Shkodër, gjatë verifikimit në këtë institucion.

Në kushtet kur gjatë analizës së akteve të administruara së bashku me ankesën, si dhe të kërkesës së institucionit për të interpretuar aspekte të ndryshme të ristrukturimit, u vendos kryeja e një hetimi më të thelluar të administrimit të shërbimit civil, në lidhje me institutin e ristrukturimit, i cili ka ndodhur pothuajse çdo vit, duke filluar nga viti 2014.

### *I. Në lidhje me institutin e ristrukturimit në Këshillin e Qarkut Shkodër.*

Nga aktet e administruara rezulton se, me vendimin nr. 9, datë 23.03.2015, të Këshillit të Qarkut Shkodër, në të cilin është miratuar struktura e këtij institucioni për vitin 2015, është përcaktuar se administrata përbëhet nga **31 punonjës**.

Sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, konstatoj se kategorizimi i nivelit më të lartë në shërbimin civil është përgjegjës sektori dhe se në të nuk ishin parashikuar pozicione të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues, pozicione që ekzistonin në strukturën e mëparshme, në të cilët ishin të punësuar nëpunës civilë, ashtu si do të analizohet në vijim të këtij materiali.

Nga analiza e akteve që materializojnë këtë proces ristrukturimi, rezulton se pas miratimit të kësaj strukture nuk është kryer asnjë veprim nga ana e institucionit, në lidhje me procedurën ligjore që duhet të ndiqet gjatë procesit të ristrukturimit, në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit për nëpunësin civil dhe të aktit nënligjor që rregullon këtë aspekt. Rezulton se nuk ka dalë asnjë akt konkret për emërimin e punonjësve në pozicionet e miratuara me strukturën e vitit 2015; edhe pse punonjësit janë paguar sipas kësaj strukture, me kategori page që i përkasin pozicionit të punës përgjegjës sektori dhe specialist.

Në këto rrethana, edhe pse nuk është zbatuar asnjë prej procedurave të kërkuara nga ligji për nëpunësin civil, fakti që punonjësit kanë pranuar të punojnë në ato pozicione pune, nuk mund t'i penalizojë ata, në drejtim të përfitimit të statusit të nëpunësit civil, në kategoritë që ata kanë fituar gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit dhe që i kanë pasur në momentin e daljes së kësaj strukture.

Më tej, rezulton se, Këshilli i Qarkut Shkodër, me Vendimin nr. 4, datë 30.01.2016, ka miratuar strukturën organizative të administratës së këtij institucioni, me 13 (trembëdhjetë) punonjës gjithsej, prej të cilëve 3 (tre) të zgjedhur dhe 10 (dhjetë) personel administrativ dhe nëpunës civil.

Prefekti i Qarkut Shkodër, me shkresën nr. 104/2 prot., datë 12.02.2016, pas shqyrtimit të Vendimit nr. 4 datë 30.01.2016, të Këshillit të Qarkut Shkodër, ka miratuar strukturën dhe numrin e punonjësve në këtë institucion, duke e vlerësuar atë si të rregullt dhe në përputhje me ligjin.

Sipas kësaj strukture, rezulton se, Këshilli i Qarkut Shkodër ka pësuar shkurtim të numrit vendeve të punës, nga **31** pozicione, që kishte struktura e mëparshme, prej të cilave **23** të përfshira në shërbimin civil, në **13** pozicione, në strukturën e re, prej të cilave vetëm **8** pozicione pune, bëjnë pjesë në shërbimin civil.

Sa më sipër rezulton se subjekti është përfshirë në proces ristrukturimit, pasi rezulton se është shkurtuar numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës, sidomos i atyre që bëjnë pjesë në shërbimin civil, (të cilat janë shkurtuar në masën, mbi 50%), si dhe janë riorganizuar njësitë përbërëse të strukturës.

Në këtë strukturë ishte parashikuar edhe krijimi i një pozicioni pune në nivelin e lartë drejtues, që është pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm. Rezulton se ky pozicion pune është plotësuar nga punonjësjë \*\*\*\*\*, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, edhe pse konstatohet një përpjekje për të konkurruar nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit, por nuk është zhvilluar procedura e ngritjes në detyrë.

Në këto kushte, akti i emërimit të punonjëses \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “*Sekretar i Përgjithshëm*”, është një akt absolutisht i pavlefshëm dhe për pasojë statusi i punësimit të kësaj punonjëseje është në kategorinë e mesme drejtuese, në pozicionin ku është deklaruar si nëpunëse civile.

Në përfundim, rezulton se akti i fundit që ka ndryshuar strukturën e Këshillit të Qarkut Shkodër, ka dalë në mbledhjen e datës 23.12.2016 “*Për strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër*”, ku me Vendimin nr. 45 datë 23.12.2016, është miratuar struktura organizative e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër, me 13 (trembëdhjetë) punonjës gjithsej, prej të cilëve 3 (tre) punonjës të zgjedhur dhe 10 (dhjetë) personel administrativ dhe punonjës të shërbimit civil.

Konstatohet se, në zbatim të detyrave funksionale, Prefekti i Qarkut Shkodër, me shkresën nr. 02/1 prot., datë 13.01.2017, ka konfirmuar Vendimin nr. 45, datë 23.12.2016, të Këshillit të Qarkut Shkodër, duke miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve që përbëjnë strukturën e këtij institucioni.

Rezulton se, sipas strukturës së re, në krahasim me strukturën e mëparshme, në Këshillin e Qarkut Shkodër, nuk evidentohet shkurtim i numrit të vendeve të punës, por vihet re se ka ndryshuar struktura organizative e institucionit në drejtim të riorganizimit të personelit administrativ të tij.

Në këtë strukturë, konstatohet se është suprimuar pozicioni i punës “*Sekretar i Përgjithshëm*”, në këtë institucion dhe nga **13** pozicione pune që kishte struktura e mëparshme, prej të cilave **8** të përfshira në shërbimin civil, në strukturën e re, vetëm **7** pozicione pune bëjnë pjesë në shërbimin civil.

Nisur nga ky fakt, arrij në përfundimin se subjekti është përfshirë në procesin e ristrukturimit, megjithëse, nuk ka shkurtim të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës, pasi konstatohet riorganizimin e burimeve njerëzore, sidomos në pozicionet që bëjnë pjesë në shërbimin civil, ku rezulton një pozicion pune më pak dhe bëhet fjalë për pozicionin që analizuam më sipër, “*Sekretar i Përgjithshëm*”.

Në këto rrethana, titullari i institucionit, në zbatim të kërkesave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë", si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit", nëpërmjet Urdhrit të brendshëm nr. 5, me nr. 84 prot., datë 20.01.2017, "Për përcaktimin e NJMBNJ në funksion të procedurave të ristrukturimit në KQSH", ka caktuar punonjësin Jozef Serrmi për kryejën e kësaj detyre.

Me Urdhrin e brendshëm nr. 4, me nr. 83 prot., datë 20.01.2017, të titullarit të institucionit, është krijuar Komisioni i Ristrukturimit. Rezulton se njoftimi për nisjen e procedurave të ristrukturimit është bërë në rrugë elektronike, me anë të shkresës nr. 69 prot., datë 18.01.2017, të Kryetares së KQSH, drejtuar të gjithë punonjësve të institucionit, por nga ana e NJMBNJ, nuk rezulton t'ju jetë komunikuar ky njoftim çdo punonjësi, ashtu si e parashikon Vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë". Provohet se të gjithë punonjësit janë njohur me shkresën e përmendur më sipër dhe për këtë arsye, shkelja e konstatuar, nuk e çënon thelbin e procedurës në këtë rast, por duhet të mbahet parasysh në të ardhmen që të respektohen kërkesat e ligjit.

Konstatohet se Komisioni i Ristrukturimit, ka shqyrtuar gjithë mundësitë e sistemimit, për secilin prej nëpunësve civilë, në vendet e lira të mbetura apo riorganizuar dhe më pas ka bërë propozimin përkatës për njësinë përgjegjëse për transferimin e nëpunësve, në ato vende pune ku ata plotësojnë kërkesat specifike.

Nga dokumentacioni që është administruar, rezulton se punonjësit e përfshirë në procesin e ristrukturimit në Këshillin e Qarkut Shkodër, janë si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, e cila është nëpunëse civile e konfirmuar, me aktin e deklaramentit të statusit të punësimin nr.489/4, datë 08.05.2014, në pozicionin e punës "Drejtoresh e Drejtoreshë së Buxhetit dhe Financës", në Këshillin e Qarkut Shkodër.  
Pas ristrukturimit të institucionit, në vitin 2016, në zbatim të Vendimit nr. 4, datë 30.01.2016, "Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër", me aktin administrativ nr.6/2, datë 15.02.2016, kjo punonjëse është emëruar në pozicionin e punës, "Drejtoresh e Drejtoreshë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Social dhe Territorial".  
Aktualisht, në zbatim të Vendimit nr. 45, datë 23.12.2016, "Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër", pas ristrukturimit, me aktin administrativ nr. 84/1 prot., datë 07.02.2017, kjo punonjëse është emëruar në pozicionin e punës, "Drejtoresh e Drejtoreshë së Zhvillimit Ekonomik, Strategjik".
2. \*\*\*\*\*, i cili është nëpunës civil i konfirmuar, me aktin e deklaramentit të statusit të punësimin nr. 489/10, datë 08.05.2014, në pozicionin e punës "Drejtor i Drejtoreshë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit", në Këshillin e Qarkut Shkodër.

Pas ristrukturimit të institucionit, në vitin 2016, në zbatim të Vendimit nr. 4, datë 30.01.2016, "*Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër*", me aktin administrativ nr. 6/4, datë 15.02.2016, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës, "*Specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorial, në Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Social dhe Territorial*", ku ai ka pranuar që të punojë.

Aktualisht, në zbatim të Vendimit nr. 45, datë 23.12.2016, "*Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër*", pas ristrukturimit, me aktin administrativ nr. 84/1 prot., datë 07.02.2017, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës, "*Specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorial, në Sektorin Juridik, Burimeve Njerëzore, Informacionit, Zhvillimit Social dhe Territorial*". Konstatohet se ky punonjës ka ulje në detyrë, por që për arsye të vazhimit të marrëdhënies së punës me institucionin, ai ka pranuar pozicionin e ri të punës, e për pasojë edhe statusin e punësimit në kategorinë që klasifikohet ky pozicion pune.

3. \*\*\*\*\*, i cili është nëpunës civil i konfirmuar, me aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr. 489/19, datë 08.05.2014, në pozicionin e punës "*Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Hartimit dhe Monitorimit të Projekteve*", në Këshillin e Qarkut Shkodër. Pas ristrukturimit të institucionit, në vitin 2016, në zbatim të Vendimit nr. 4, datë 30.01.2016, "*Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër*", me aktin administrativ nr.6/6, datë 15.02.2016, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës, "*Përgjegjës Sektori në Sektorin e Projekteve në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Projekteve*", pozicion në të cilin ai ka pranuar të punojë.

Aktualisht, në zbatim të Vendimit nr. 45, datë 23.12.2016, "*Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër*", pas ristrukturimit, me aktin administrativ nr. 84/1 prot., datë 07.02.2017, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës, "*Specialist në Sektorin e Hartimit të Projekteve, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, Prokurimeve dhe Projekteve*". Konstatohet se ky punonjës ka ulje në kategori, por, për të vazhduar marrëdhënien e punës me institucionin, pas ristrukturimit, ai e ka pranuar pozicionin e ri të punës, e për pasojë edhe statusin e punësimit në kategorinë që klasifikohet ky pozicion pune.

4. \*\*\*\*\*, i cili është nëpunës civil i konfirmuar, me aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr. 489/26, datë 08.05.2014, në pozicionin e punës "*Specialist i Marrdhënieve me publikun, në Drejtorinë e Burimeve njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme*", në Këshillin e Qarkut Shkodër. Pas ristrukturimit, në vitin 2016, në zbatim të Vendimit nr. 4 datë 30.01.2016, "*Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër*", me aktin administrativ nr. 6/3, datë 15.02.2016, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës, "*Përgjegjës Sektori në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit, Social në Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Social dhe Territorial*".

Aktualisht, në zbatim të Vendimit nr. 45, datë 23.12.2016, "*Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër*", pas ristrukturimit, me aktin

administrativ nr. 84/1 prot., datë 07.02.2017, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës, *“Specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorial, në Sektorin Juridik, Burimeve Njerëzore, Informacionit, Zhvillimit Social dhe Territorial”*.

Konstatohet se emërimi i këtij nëpunësi në pozicionin *“Përgjegjës Sektori në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit, Social në Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Social dhe Territorial”*, me aktin administrativ nr. 6/3, datë 15.02.2016, është bërë pa respektuar procedurat e përcaktuara në nenin 26 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore. Rezulton se në këtë rast, ligjshmëria është rivendosur pas ristrukturimit që po analizojmë, me propozimin e Komisionit të Ristrukturimit, me aktin nr. 84/1 prot., datë 07.02.2017, duke e kaluar këtë punonjës në pozicionin e punës në kategorinë e statusit të tij të punësimit, *“Specialist”*.

5. \*\*\*\*\*, i cili është nëpunës civil i konfirmuar, me aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 489/13, datë 08.05.2014, në pozicionin e punës *“Përgjegjës Sektori në Sektorin e Transportit dhe Emergjencës, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Transportit dhe Emergjencës”*, në Këshillin e Qarkut Shkodër.

Pas ristrukturimit të vitit 2016, në zbatim të Vendimit nr. 4, datë 30.01.2016, të Këshillit të Qarkut Shkodër, *“Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër”*, me aktin administrativ nr. 51, datë 05.08.2016, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës, *“Specialist në Sektorin e Prokurimeve Publike në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Projekteve”*.

Aktualisht, në zbatim të Vendimit nr. 45, datë 23.12.2016, *“Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër”*, pas ristrukturimit, me aktin administrativ nr. 84/1 prot., datë 07.02.2017, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës, *“Specialist në Sektorin e Transportit e Shërbimeve të Brendshme, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, Prokurimeve dhe Projekteve”*. Konstatohet se ky punonjës ka ulje në kategori, por, për të vazhduar marrëdhënien e punës me institucionin, pas ristrukturimit, ai e ka pranuar pozicionin e ri të punës, e për pasojë edhe statusin e punësimit në kategorinë që klasifikohet ky pozicion pune.

6. \*\*\*\*\*, e cila është nëpunëse civile e konfirmuar, me aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 489/5, datë 08.05.2014, në pozicionin e punës *“Drejtoreshë e Drejtorisë së Prokurimeve Publike”*, në Këshillin e Qarkut Shkodër.

Pas ristrukturimit të vitit 2016, në zbatim të Vendimit nr. 4, datë 30.01.2016, *“Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër”*, me aktin administrativ nr. 6/5, datë 15.02.2016, kjo punonjëse është emëruar në pozicionin e punës, *“Drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Projekteve”*.

Aktualisht, në zbatim të Vendimit nr. 45, datë 23.12.2016, *“Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër”*, pas ristrukturimit, me aktin administrativ nr. 84/1 prot., datë 07.02.2017, kjo punonjëse është emëruar në pozicionin e punës, *“Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, Prokurimeve dhe Projekteve”*.

Konstatohet se kjo punonjëse është ulur në kategori, por, për të vazhduar marrëdhënien e punës me institucionin, pas ristrukturimit, ajo e ka pranuar pozicionin e ri të punës, e për pasojë edhe statusin e punësimit në kategorinë që klasifikohet ky pozicion pune.

7. \*\*\*\*\*, i cili është nëpunës civil i konfirmuar, me aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 489/27, datë 08.05.2014, në pozicionin e punës *“Zëdhënës, Këshilltar i Marrëdhënieve me Jashtë”*, në Këshillin e Qarkut Shkodër. Me Vendimin 34, datë 22.04.2015, të KMSHC, pika 4, në lidhje me këtë punonjës është kërkuar revokimi i aktit të deklarimit të statusit të punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se pozicioni i punës, nuk futet në fushën e veprimit të shërbimit civil. Por nga ana tjetër, është rekomanduar institucioni, se, nëse pretendohet që ky pozicion është pjesë e shërbimit civil, atëherë duhet të njehsohet pozicioni i punës, me emërtesat dhe klasat e nëpunësisë civile.

Rezulton se, pas ristrukturimit të vitit 2016, në zbatim të Vendimit nr. 4, datë 30.01.2016, *“Mbi strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër”*, me aktin administrativ nr. 6/8, datë 15.02.2016, pozicioni i tij i punës është njehsuar me pozicionin e punës, *“Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Komunikimit dhe Informacionit, kategoria II, Klasa-b”*. Në këto kushte, Komisioneri, nëpërmjet vendimit nr. 70, datë 20.06.2016, ka konstatuar rregullimin e ligjshmërisë, në lidhje me këtë aspekt.

Aktualisht, pas ristrukturimit të fundit të institucionit, ky punonjës është emëruar në një pozicion pune që nuk përfshihet në shërbimin civil, *“Këshilltar i Marrëdhënieve me Jashtë”*, me aktin administrativ nr.84/1 prot., datë 07.02.2017, të NJMBNJ.

Rezulton se në kushtet kur, ky pozicion pune, nuk përfshihet në fushën e veprimit të shërbimit civil, me shkresën datë 02.07.2017, punonjësi kërkuar nga njësia përgjegjëse, pezullimin e statusit të nëpunësit civil, e cila është miratuar.

8. Në momentin e verifikimit, pozicioni i punës *“Përgjegjës Sektori”*, në Sektorin Juridik, Burimeve Njerëzore, Informacionit, Zhvillimit Social dhe Territorial, ishte i lirë.

Në përfundim sa më sipër, arrij në konkluzionin se, janë lejuar parregullsi gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit, të cilat konsistojnë në momentin kur, punonjësve të këtij institucioni, nuk i është komunikuar në mënyrë individuale, njoftimi për nisjen e procedurave të ristrukturimit, por, ashtu siç theksohet edhe më sipër, kjo parregullsi nuk e cënon në thelb procesin, në kushtet kur nëpunësit kanë marrë dijeni nëpërmjet rrugës elektronike për këtë fakt.

Konstatohet se të gjitha aktet administrative të nxjerra nga NJMBNJ, në përfundim të këtij procesi mbajnë të njëjtin numër akti (84/1), ndërkohë që duhet të ishin individuale për çdo punonjës.

Gjithashtu, në përmbledhje të fazës së risistemimit të punonjësve në pozicionet e reja të punës, pas ristrukturimit, konstatohet se punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, janë ulur në kategori, por që, për arsye të vazhdimin të marrëdhënies së punës me institucionin,

ata e kanë pranuar pozicionin e ri të punës, e për pasojë edhe statusin e nëpunësit civil që i përgjigjet këtij pozicioni në shërbimin civil.

Rezulton se për punonjësin \*\*\*\*\*\*, njësia përgjegjëse në institucion, pas miratimit të propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, nëpërmjet aktit nr. 84/1 prot., datë 07.02.2017, ka rregulluar paligjshmërinë e veprimit juridik të ngritjes në detyrë, në pozicion e punës *“Përgjegjës Sektori në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit, Social në Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Social dhe Territorial”*, materializuar me aktin administrativ nr.6/3, datë 15.02.2016, në kundërshtim me procedurat ligjore, duke e kaluar përfundimisht këtë punonjës në pozicionin e punës të nivelit *“Specialist”*.

## **II. Në lidhje me ankesën e punonjësës \*\*\*\*\*.**

Nga aktet e administruara, konstatohen parregullsi gjatë procedurës së kryer për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjësën \*\*\*\*\*\*, pasi nuk janë respektuar rregullat e përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe në Kreun II, të Vendimit nr. 125, dt. 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë”*, që kanë të bëjnë me detyrimin e njësisë përgjegjëse për të njoftuar në mënyrë individuale punonjësit për nisjen e procedurave të ristrukturimit në institucion. Në rastin konkret, ky njoftim është kryer në rrugë elektronike, për të gjithë punonjësit, duke mos marrë parasysh përcaktimet e ligjit.

Edhe pse ky mosveprim në thelb nuk e çënon procesin, pasi nëpunësi ka pasur mundësi që të paraqesë kundërshtimet në lidhje me pretendimet e tij, e theksoj këtë rast, me qëllim që njësia përgjegjëse të veprojë drejt në të ardhmen, në një situatë të tillë.

Bazuar në rregullin e përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; si dhe në aktet nënligjore që rregullojnë procesin e ristrukturimit, që janë Vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”* dhe Udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016, i Departamentit të Administratës Publike *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*, detyra e Komisionit të Ristrukturimit, është që të vlerësojë, ndërmjet të tjerave, nëse ekziston mundësia për sistemimin në ndonjë pozicion të mbetur, të punonjësve të institucionit, të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës, ashtu si në rastin e punonjësës \*\*\*\*\*.

Konstatohet se, Komisioni i Ristrukturimit në këtë rast, i ka shqyrtuar gjithë mundësitë e sistemimit, për punonjësën \*\*\*\*\*\*, në vendet e lira të mbetura apo riorganizuar dhe më pas ka bërë propozimin përkatës për njësinë përgjegjëse për transferimin e saj, në atë vend pune ku ajo plotësonte kërkesat specifike.

Në përfundim të këtij veprimi administrativ, nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, është vlerësuar se ajo mund të sistemohej në një prej pozicioneve të mbetura, prandaj, me shkresën nr. 83/1 prot., datë 31.01.2017, është paraqitur propozimi përpara njësisë përgjegjëse, për transferimin e nëpunëses në fjalë, në pozicionin e punës *“Përgjegjës Sektori”*, në Sektorin



Juridik, Burimeve njerëzore, Informacionit, Zhvillimit social dhe territorial, të krijuar në strukturën e re të institucionit. Mbi këtë bazë, më pas, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin administrativ nr. 84 prot., datë. 07.02.2017, për transferimin e nëpunëses \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin Juridik, Burimeve njerëzore, Informacionit, Zhvillimit social dhe territorial, kategoria III-a/1.

Në vijim të kësaj procedure, nëpërmjet shkresës 164/1 prot., datë 14.02.2017, nëpunëses i është kërkuar mendimi me shkrim, nëse është dakord, me transferimin për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Rezulton se, punonjësja \*\*\*\*\* me shkresën nr. 164/2 prot., datë 14.02.2017, ka refuzuar transferimin për shkak të ristrukturimit të institucionit, me arsyen ky pozicioni ri pune, nuk është i të njëjtës kategori me atë të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe ka kërkuar përfundimin e marrëdhënies së punës, në përputhje me parashikimet ligjore.

Ndodhur në këto kushte, njësia përgjegjëse e institucionit, me Urdhrin nr.9, datë 01.03.2017, ka ngritur përsëri Komisionin e Ristrukturimit, i cili me shkresën nr. 235, datë 02.03.2017, në pamundësi të sistemimit sipas pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), në pozicionet e punës të krijuara në strukturën e re, bazuar në pikën 16, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë”, i ka propozuar njësisë përgjegjëse, lirin nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, të nëpunëses \*\*\*\*\*. Ndërsa, për sa i përket dëmshpërblimit, si edhe vendosjes në listë pritje, është kërkuar prej KMSHC dhe DAP, një mendim më i specializuar.

Në përfundim të këtij veprimi administrativ, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr. 236 prot., datë. 02.03.2017 “Për deklarin e lirit nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit dhe ndryshimit të kriterëve të vendit të punës, të \*\*\*\*\* me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, në KQSH”.

Në lidhje me kërkesën e institucionit, për mendim të specializuar, që ka të bëjë me aplikimin e dëmshpërblimit që punonjësja \*\*\*\*\* duhet të përfitojë si pasojë e lirit nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe ndryshimit të kriterëve të vendit të punës, vlerësoj se:

Sipas dokumentacionit të mbledhur, konstatoj se punonjësja \*\*\*\*\* është deklaruar nëpunëse civile me aktin administrativ nr. 489/18, datë 08.05.2014, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Hartimit dhe Monitorimit të Projekteve”, kategoria e pagës II-b, në Këshillin e Qarkut Shkodër.

Në vijim, rezulton se KQSH, me vendimin nr. 9, datë 23.02.2015, ka miratuar strukturën dhe organikën e re të institucionit, në të cilën nuk ekziston pozicioni i punës “Drejtor i Drejtorisë të Hartimit dhe Monitorimit të Projekteve”.

Nga struktura organizative e vitit 2015, në këtë institucion, rezulton se punonjësja \*\*\*\*\* ka kaluar në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektorit të Hartimit dhe Monitorimit të Projekteve”, kategoria e pagës III-a/1. Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion, kjo punonjëse nuk rezulton që të ketë refuzuar uljen në detyrë. Megjithatë, në kushtet kur në këtë rast ristrukturimi,

nuk janë zbatuar procedurat ligjore, ky veprim juridik vlerësohet si absolutisht i pavlefshëm dhe ashtu siç është analizuar edhe më sipër, do të konsiderohet se nuk ka ekzistuar dhe nuk duhet të ndikojë në statusin e punësimit, të deklaruar në përputhje me nenin 67, të ligjit për nëpunësin civil, të cilin nëpunësja e ka në nivelin “*Drejtor Drejtorie*”.

Më tej, rezulton se me Urdhrin e brendshëm të titullarit të institucionit, nr. 6/1 datë 15.02.2016, punonjësja \*\*\*\*\* emërohet Sekretare e Përgjithshme në këtë institucion. Nga aktet e administruara, konstatoj se nuk është kryer asnjë procedurë ligjore, për ngritjen në detyrë, ashtu si e parashikon neni 25, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar).

Emërimi i punonjësës në pozicionin e punës “*Sekretare e Përgjithshme*”, duke mos kryer procedurat e mësipërme, vjen në kundërshtim me kërkesat e ligjit, e për pasojë nuk mund të krijojë të drejta.

Në këtë kontekst, njësia përgjegjëse, në përlogaritjen e dëmshpërblimit që punonjësja \*\*\*\*\* përfiton, si pasojë e lirimit nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe ndryshimit të kriterëve të vendit të punës, duhet të ketë parasysh si pozicion të mëparshëm të punës, “*Drejtor në Drejtorinë e Hartimit dhe Monitorimit të Projekteve*”, kategoria e pagës II-b, ku edhe punonjësja është deklaruar si nëpunëse civile.

Në aktin e lirimit nga shërbimi civil, i punonjësës duhet të mbahen parasysh kërkesat e nenit 50, pikat 6 deri 8, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet se duhet t’i paguhet dëmshpërblimi në përputhje me vjetërsinë në punë, e njëkohësisht duhet t’i bëhet e ditur e drejta që ajo ka për të konkurruar për një periudhë 2 vjeçare, për lëvizje paralele, në pozicionet e punës “*Drejtor Drejtorie*”.

Dëmshpërblimi duhet të fillojë të paguhet, duke nisur nga data e daljes së aktit administrativ që e liron punonjësën nga shërbimi civil.

Për të gjithë kohën tjetër, para daljes së aktit të lirimit nga shërbimi civil, kur punonjësja nuk është paguar, do të marrë pagën e Sekretarit të Përgjithshëm, detyrë të cilën e ka kryer deri në momentin e daljes së aktit të lirimit nga shërbimi civil.

Nga gjithë sa më sipër, arrij në përfundimin që, akti administrativ nr. 236 prot., datë 02.03.2017, “*Për deklarimin e lirimit nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit dhe ndryshimit të kriterëve të vendit të punës, të \*\*\*\*\**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, në KQSH”, është nxjerrë duke respektuar kërkesat dhe procedurën e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; kreun II të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë*” dhe Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit*”.

Pëfundimisht çmoj se pretendimet e ngritura nga punonjësja, që ka kërkuar verifikimin e ligjshmërisë së procedurës së ndjekur, në kryerjen e procesit të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Shkodër, në zbatim të vendimit nr. 45, datë 23.12.2016, për miratimin e strukturës së re të këtij institucioni, se përbërja e Komisionit të Ristrukturimit nuk ka qenë e rregullt, se nuk është

njoftuar individualisht nga njësia e burimeve njerëzore etj., qëndrojnë pjesërisht, ashtu si e analizuam më sipër, por në thelb, nuk e kanë çenuar procesin.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14, 15 dhe 50 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 16, dhe 35, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që për punonjësën \*\*\*\*\*\*, të vijojë me plotësimin e aktit, në zbatim të përfitimeve që rrjedhin prej nenit 50, pikave 7 dhe 8, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, që kanë të bëjnë me dhënien e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojë si nëpunëse civile për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohet në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e saj, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore.
2. Njësia përgjegjëse, duhet të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, në përlllogaritjen e dëmshpërblimit, që punonjësja \*\*\*\*\*\* përfiton si pasojë e lirimit nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe ndryshimit të kriterëve të vendit të punës, duke pasur parasysh si pozicion të mëparshëm të punës, atë të “*Drejtor në Drejtorinë e Hartimit dhe Monitorimit të Projekteve*”, kategoria e pagës II-b, ku edhe punonjësja është deklaruar si nëpunëse civile
3. Dëmshpërblimi duhet të fillojë të paguhet, duke nisur nga data e daljes së aktit administrativ që e liron punonjësën nga shërbimi civil, në zbatim të përfitimeve që rrjedhin prej nenit 50, pikës 7, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
4. Për të gjithë kohën tjetër, para daljes së aktit të lirimit nga shërbimi civil, kur punonjësja nuk është paguar, duhet të marrë pagën e Sekretarit të Përgjithshëm, detyrë të cilën e ka kryer deri në momentin e daljes së aktit të lirimit nga shërbimi civil.
5. Në të ardhmen, njësia përgjegjëse duhet të bëjë kujdes dhe të zbatojë me përpikmëri procesin e ristrukturimit të institucionit, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke filluar me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili duhet të funksionojë dhe veprojë sipas përcaktimeve dhe afateve të përcaktuara në kreun II të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë*”.

6. Këshilli i Qarkut Shkodër, të zbatojë vendimin brenda **15** ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për zbatimin e vendimit.
7. Të njoftohen për këtë vendim Këshilli i Qarkut Shkodër dhe kërkuesja \*\*\*\*\*.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**